



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:194912
Datë: 07.06.2024
Numri i dokumentit: 05795490

KPPP.nr.1295/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KESco), me NUI: 811288887, me seli në Rr. "Bill Klinton", Nr. 5, në Prishtinë, kundër debitorit D.P.Z. "B&B" K.J.T., me seli në Mitrovicë Rr. "Sheshi Adem Jashari", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Safet Voca, avokat nga Mitrovica, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.1039/19 të datës 18.06.2019, të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri, jashtë seancës, me datë 07.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D.P.Z. "B&B" K.J.T., ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.1039/19 i datës 18.06.2019, i Përmbaruesit Privat Atip Mustafa dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.1039/19 të datës 18.06.2019, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist me numër unik të konsumatorit DMI - 9010469, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të këtij vendimi, të paguaj borxhin në shumën prej 941.77 € për konsumin e energjisë elektrike të krijuar nga data 29.07.2016 deri me datën 12.05.2019, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit bashkë me shpenzimet e ekzekutimit, në llogarinë bankare të kreditorit, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të bëhet

me ndalimin e mjeteve në para nga llogaritë rrjedhëse të debitorit dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, ndalimin e mjeteve në të ardhurat personale ose me regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit, deri në përmbushjen e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se nuk është juridikisht i vlefshëm dhe i papërshtatshëm për përmbarim sepse propozimi nuk i përmban të gjitha kushtet e kërkuara ligjore. Ka shtuar se propozimi për përmbarim nuk i përmban të gjitha kushtet e kërkuara ligjore për faktin sepse i njëjti nuk i përmban me saktësi shënimet e kërkuara sa i përket identitetit të debitorit dhe se në rastin konkret lejimi i përmbarimit në këtë çështje përmbarimore është ndaj debitorit i cili ka vdekur në vitin 1995 dhe po ashtu nuk është përcaktuar me saktësi lartësia e borxhit, periudha kohore e krijuar e këtij borxhi dhe nuk është përcaktuar si duhet objekti, lloji dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Tutje ka theksuar se borxhi tani më nuk mund të kërkohet se kërkesa është shuar gjegjësisht është parashkruar në tërësi për vitet paraprake kalendarike për të cilat kreditori e kërkon borxhin. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të miratohet dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi, duke theksuar ndër të tjera se kreditori ka ushtruar propozimin për përmbarim konform rregullave dhe procedura ligjore, përkatësisht duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afarist. Më tutje ka shtuar se borxhi i cekur si në propozim i përket faturave të rregullta të energjisë elektrike të shpenzuara për periudhën kohore prej datës 23.12.2017 deri me datën 06.02.2020 dhe se tek kriteri minimal është i precizuar borxhi kumulative dhe jo i ndarë në fatura mujore. Në lidhje me pretendimet e debitorit se kërkesa është parashkruar, ka deklaruar se debitori me ka bërë pagesa të kohëpaskohshme me vlera të ndryshme duke manifestuar pranimin e borxhit konform nenit 368 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat dhe në rast të ndonjë paqartësie të caktojë seancë publike në këtë çështje.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.672/2019 të datës 12.12.2019, prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar dhe urdhrin përmbarimor P.nr.1039/19 të datës 18.06.2019, e ka shfuqizuar pjesërisht.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.2666/2020 të datës 27.07.2021, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, duke prishur Aktvendimin PPP.nr.672/2019 të datës 12.12.2019, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat sipas ekstraktit nga librat afariste, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 29, par.1 nën par 1.2 të LPP-së, për faktin se përmban të meta në raport me objektin e detyrimit, përkatësisht i njëjti ekstrat nuk pasqyron vetëm borxhin e debitorit si rezultat i furnizimit me energji elektrike dhe kjo për faktin që në ekstraktin afarist DMI – 9010469, rezulton se debitori me datën 26.09.2018, është ngarkuar edhe me detyrim në emër të *“rikthimit të humbjeve”* në shumën prej 222.23 €, e cila evidentohet sipas referencës nr.113 DMI18HP13393 si dhe me datën 15.01.2019, është ngarkuar edhe me

detyrim në emër të “rikthimit të humbjeve” në shumën prej 373.35 €, e cila evidentohet sipas referencës nr.119 DMI19HP13954.

Andaj, duke qenë se me dispozitat nga neni 29, par.1 nën par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht se dokumente të besueshëm janë ekstraktet të cilat për objekt detyrimi kanë borxhin e krijuar si rezultat i furnizimit me energji elektrike, ndërsa kreditori në ekstrakt ka faturuar edhe borxhin për rikthimin e humbjeve, si dhe duke marr parasysh faktin që kreditori përmes këtij ekstrakti ka kërkuar edhe përmbushjen e detyrimeve të cilat nuk përfshijnë periudhën kohore për të cilën është iniciuar procedura përmbartimore, gjykata vlerëson se në rastin konkret ekstrakti DMI – 9010469, nuk përbën dokument të besueshëm dhe nuk është i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata morri parasysh edhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.2666/2020 të datës 27.07.2021, me anë të së cilës është udhëzuar gjykata e shkallës së parë që të vërtetoj faktin e legjitimitet të palëve në procedurë, dhe pas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, në bazë të ID së pronarit si në propozim, J.T. është pronar/aksionar i debitorit i cili edhe ka nënshkruar autorizimin për përfaqësim.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Meqenëse gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi për këto arsye, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet e tjera të debitorit dhe kreditorit lidhur me parashkrimin e kërkesës.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitorit, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1295/22, datë 07.06.2024

Gjyqtari
Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.